

NIKLAS LUHMANN

SHORT CUTS

Gjerdani i botimeve RRATHË: Filozofi - Psikologji - Politologji

Lektorimi letrar: Silvana Leka

Titulli i originalit: Short cuts (2000), Zweitausendeins,
Frankfurt am Main

Përgatitur për botim nga Peter Gente, Heidi Paris,
Martin Weinmann

Redaktimi shkencor: Dr. Klementin Mile

Realizimi grafik dhe ballinat: Geppetto's Studio

Copyright © 1987, 1997 by Merve Verlag, Berlin
Copyright © i këtij edicioni "Botimet Poeteka", 2017

ISBN 978-9928-230-03-4

Copyright © of the translation: S. Fischer Foundation by order
of TRADUKI

traduki 

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale për Europë, Integrim dhe Punë të Jashtme e Republikës së Austrisë, Zyra e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni zviceran "Pro Helvetia", "KulturKontakt Austria" (ngarkuar nga Zyra e Kancelarit Federal të Republikës së Austrisë), Instituti "Goethe", Agjencia Sllovene e Librit "JAK", Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe e Informimit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Republikës së Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni "S. Fischer".

Botimet Poeteka
Rr. "Frederik Shiroka"
K.II, Kt. 2, Tiranë
infopoeteka@gmail.com
<http://poeteka.blogspot.al>

Shtypshkronja

INTERGRAFIKA
www.intergrafika.net

Niklas Luhmann

SHORT CUTS

ese — artikuj — intervista

Përktheu nga gjermanishtja
Anila Shuka



BOTIMET POETIKA

Përmbajtja

| | |
|--|-----|
| Dy fjalë për autorin..... | 7 |
| Përse Luhmann?..... | 9 |
| Biografi, atituda, skedarë..... | 20 |
| Çfarë është komunikimi?..... | 56 |
| Njet-set dhe terror-desperados..... | 79 |
| Alternativë pa alternativë..... | 90 |
| Edhe brenda, edhe kundër..... | 96 |
| Futbolli..... | 103 |
| Risk në çdo rast..... | 106 |
| Si votuam?..... | 114 |
| Depresion statistikor..... | 122 |
| Edhe mendjengushtë, edhe empatikë..... | 128 |
| Kirurg në park..... | 135 |
| Art konceptual..... | 142 |
| Prandaj dashuri..... | 150 |
| Si të lexojmë..... | 165 |

Dy fjalë për autorin

Niklas Luhmann u lind më 8 dhjetor 1927, si bir i një pronari të një fabrike birre, në qytetin e vogël gjermano-verior, Lüneburg. Në moshën 17-vjeçare, ende në shkollë, u rekrutua nga forcat ajrore të Vermahtit dhe në vitin 1945 u kap rob lufte nga amerikanët.

Në vitet 1946-1949 studioi për Drejtësi në Freiburg, ku kreu edhe vitin praktik si jurist. Në vitin 1952 nis ndërtimin e kartotekës së tij të famshme. Në vitet 1954-1962 Niklas Luhmann punoi si nëpunës administrate në Lüneburg, fillimisht në Gjykatën e Lartë Administrative e më pas si raportues për Ministrinë e Kulturës së Saksonisë së Poshtme në Kuvendin rajonal. Vitet 1960/61 e gjejnë në SHBA, pasi fiton një bursë në Universitetin Harvard, ku edhe njihet me sociologun amerikan, Talcott Parsons, një ndër etërit e teorisë së sistemeve.

Më pas ai do t'i kushtojë gjithnjë e më shumë kësaj fushe. Prej vitit 1968 deri në vitin 1993 do të jetë profesor sociologjie në Universitetin e Bielefeld-it, i cili sot mban emrin e tij. Në vitin

1997 u botua vepra kryesore e tij, „Die Gesellschaft der Gesellschaft“ (Shoqëria e Shoqërisë), një teori sociologjike me karakter universal, rezultat i një pune 30-vjeçare.

Niklas Luhmann konsiderohet si një ndër mendimtarët më të shquar gjermanë të shekullit XX, krahas Jürgen Habermas-it, me të cilin ka zhvilluar edhe shumë polemika shkencore. Vdiq më 6 nëntor 1998, në Oerlinghausen pranë Bielefeld-it.

Përse Luhmann?

*Në vend të parathënies
për botimin në gjuhën shqipe*

Është e vështirë të shkruash një parathënie për Niklas Luhmann-in. Kjo pasi detyrohesh që në pak faqe të gjykosh për mijëra faqe librash dhe artikujsh të shkruar prej tij. Siç do të thoshte vetë Luhmann, detyrohesh që për të reduktuar kompleksitetin e veprës, të arrish në parathënie një kompleksitet të një rendi më të lartë. Por jo vetëm kaq. Detyra e kësaj parathënieje bëhet edhe më e vështirë nga fakti që është hera e parë që Luhmann i prezantohet lexuesit shqiptar.

Po e nis nga një përvojë personale. 10 vite më parë, pra në vitin 2006, ndërsa po lexoja librin *Thinking Sociologically* (Të Mendosh Sociologjikisht) të sociologut të njohur Zygmunt Bauman, zbulova që ekzistonte një libër sociologjik që trajtonte çështjen e intimitetit; ky libër ishte *Love as Passion* (Dashuria si Pasion) nga Niklas Luhmann. Habia dhe kurioziteti im ishte i plotë. Deri atëherë

kisha lexuar libra për intimitetin, por vetëm nga këndvështrimi letrar, historik, psikologjik dhe filozofik. Nuk arrija ta përfytyroja dot se çfarë mund të thuhej për intimitetin nga këndvështrimi sociologjik. A nuk merrej sociologjia me fenomenet sociale, me divorcin, me devijancën, me fenë, me urbanizimin? Si mund të merrej edhe me një fenomen kaq pak social, kaq privat, të brendshëm dhe shpirtëror si intimiteti?!

Interesi që m'u zgjua prej kësaj më shtyu të porosis blerjen në gjuhën angleze të tre librave të Luhmann-it: *Love as Passion, Social Systems* (Sistemet Sociale) dhe *Law as a Social System* (E Drejta si Sistem Social). Librat nuk erdhën në të njëjtën kohë. Për fat të mirë, më herët erdhi libri më i vështirë dhe më sistematik i Luhmann-it, *Social Systems*. Them për fat të mirë, pasi nuk do kisha arritur ta kuptoja *Love as Passion* pa lexuar më parë *Social Systems*. Në botën akademike Luhmann është i famshëm për vështirësinë e teksteve të tij, aq sa shpesh kjo përbën një pengesë për përhapjen e mendimit luhmannian. Kjo ka të bëjë me terminologjikë specifike luhmanniane, që është krejt e ndryshme nga ajo e traditës sociologjike. Para Luhmann-it nuk gjeje në librat sociologjikë koncepte si autopoiezë, kontingjencë, kompleksitet apo kod. Këto dhe koncepte të tjera Luhmann i huazoi nga fusha të tjera, të cilat, sipas tij, ishin

më të zhvilluara se sociologjia: nga kibernetika, nga biologjia, nga shkenca kompjuterike, nga filozofia, nga matematika etj. Edhe në rastet kur Luhmann përdor terma të njohur në sociologji si vlerat, normat, vëzhgimi, variacioni, programi, diferenca, veprimi, komunikimi, struktura, sistemi – këto terma përkufizohen ndryshe nga tradita sociologjike, duke formuar në këtë mënyrë koncepte të reja. Me fjalë të tjera, të lexosh Luhmann-in do të thotë të harrosh ç'ke mësuar prej traditës së Weber-it, Durkheim-it, Marx-it, Simmel-it, Parsons-it etj. dhe të vësh në punë imagjinatën me kohë të plotë. Luhmann ka thënë vazhdimisht që është sociolog, por ama e ka ndjekur shumë pak traditën sociologjike dhe është frymëzuar shumë pak prej saj. Arsyeja për këtë është se, sipas Luhmann-it, sociologjia është në krizë.

Sociologët nuk bëjnë gjë tjetër veçse përpunojnë tezat e klasikëve të sociologjisë, pa arritur të prodhojnë ndonjë risi, duke e lënë kështu në stanjacion teorinë sociologjike. Po të marrim në konsideratë nivelin e abstraksionit të veprës luhmanniane dhe ndikimet më të rëndësishme të Luhmann, fare lehtë do mund ta cilësonim filozof dhe jo sociolog.

Por në fakt Luhmann na tregoi se të jesh sociolog, përkundër opinionit mbizotërues, është shumë e vështirë. Të jesh sociolog do të thotë të kesh dije

të zhvilluara jo vetëm në filozofi, kibernetikë, biologji dhe logjikë, por edhe në shkencat politike, ekonomike, juridike etj. Pas Luhmann-it është bërë shumë e vështirë të jesh sociolog – aq të larta janë standardet e vendosura prej tij.

Korpusi i veprës luhmanniane mund të kategorizohet në tri pjesë kryesore: aparati konceptual, studimet monografike, dhe studimi i shoqërisë. Luhmann e zhvillon aparatën konceptual në mënyrë sistematike të libri *Social Systems*. Aty ai bën ndarjen e plotë me traditën sociologjike dhe zhvillon koncepte të reja për të analizuar fenomenet sociale. Për t'u përmendur është fakti që për herë të parë Luhmann argumenton se sociologjia nuk duhet të fokusohet te koncepti i veprimit siç kishin bërë të gjithë sociologët para tij, por te koncepti i komunikimit. Ndryshe nga veprimi, të themi pirja e kafesë, i cili mund të ndodhë i izoluar nga shoqëria, komunikimi është gjithmonë një akt social. Sipas Luhmann-it, ai ka tre përbërës: informacioni, kumtimi dhe kuptimi, dhe vetëm kur këta të tre bëhen së bashku, krijohet ajo njësi elementare sociale që quhet komunikim. Me të nis socialja. Dhe një nga shprehjet më të debatuar të Luhmann-it është që nuk komunikojnë njerëzit, por komunikojnë komunikimi.

Gjithashtu Luhmann pozicionon sistemin si konceptin vendimtar për teorinë e tij dhe i dallon

sistemet sociale nga sistemet e tjera: nga sistemet psikike, sistemet mekanike, sistemet organike, etj. Si sociolog, Luhmann vendos të studiojë sistemet sociale, të cilat, nga ana e tyre, janë sisteme ndërveprimi, sisteme organizative, dhe sisteme shoqërore. Edhe pse Luhmann ka shkruar libra dhe artikuj për sistemet e ndërveprimit dhe sistemet organizative, fokusi kryesor i tij ishte sistemi i shoqërisë. Kjo sepse sociologjia kishte dështuar deri atëherë të prodhonte një teori të shoqërisë, pa të cilën, vështirë se mund të kuptoheshin si duhet fenomenet sociale të pjesshme.

Për të prodhuar këtë teori të shoqërisë Luhmann punoi 30 vjet. Madje është i famshëm episodi kur Luhmann u pranua në Universitetin e Bielefeld-it, në vitin 1967, dhe iu kërkua të plotësonte një formular me tri pyetje: Çfarë do krijoni? Një teori të shoqërisë. Sa kohë ju duhet për këtë? 30 vjet. Sa do i kushtojë universitetit kjo? Asgjë. Gjatë kësaj periudhe 30-vjeçare Luhmann punoi edhe për studimet monografike të tij. Ai shkroi libra për të drejtën, për politikën, për artin, për fenë, për shkencën, për edukimin, për dashurinë, për masmedian, për ambientin, për protestën, për organizatat etj. Në këto libra zhvillohen dhe konkretizohen idetë abstrakte të *Social Systems* dhe përgatitet publiku për veprën monumentale *Die Gesellschaft der Gesellschaft* (Shoqëria e Shoqërisë).

Në këtë vepër të fundit, që u botua në vitin 1997, një vit para vdekjes, Luhmann zhvillon, për herë të parë në sociologji, një teori të shoqërisë. Kjo është një vepër antihumaniste (në kuptimin që e relativizon ndikimin e njeriut në shoqëri), antirajonaliste (pasi nisat nga probleme universale të shoqërisë për të kuptuar më mirë diferencat ndërmjet rajoneve të ndryshme të botës) dhe radikalisht konstruktiviste. Kjo mënyrë e të parit të shoqërisë, e çpersonalizon dhe e çkombëtarizon zhvillimin e saj, duke mos i lënë as meritat e as fajin një personi ose një kombi të vetëm për sa ndodh në shoqëri. Përkundrazi, duhen parë strukturat e sistemeve përbërëse të shoqërisë. Një vëzhgim i tillë padyshim që e çtensionon debatin dhe e kthen vëmendjen nga esencjalja.

Sipas Luhmann-it, shoqëria moderne diferencohet në sisteme funksionale, pikërisht në sistemet për të cilat ai zhvilloi studime monografike: politikë, ekonomi, fe, art, shkencë, edukim, masmedia, e drejtë etj. Këto sisteme janë autopoietike, pra riprodhojnë veten, janë vetëreferenciale, pra kanë secili logjikën e vetë autonome të funksionimit, dhe orientohen nga vlera të ndryshme nga njëri-tjetri, shpërblejnë dhe ndëshkojnë në mënyra të ndryshme dhe kanë zhvilluar gjuhë të ndryshme. Pikërisht problemi i gjuhëve të ndryshme është problemi themelor i shoqërisë moderne. Shoqëria

moderne vuan nga pamundësia për të krijuar një metagjuhë, një gjuhë që t'u imponohet dhe t'i unifikojë gjuhët specifike të sistemeve të saj. Këtë sot nuk mund ta bëjë as gjuha e moralit, e as ajo fetare dhe ajo politike. Të tilla axhenda Luhmann i quan utopike.

Libri *Short Cuts*, që i vihet në dispozicion lexuesit shqiptar, është botuar në vitin 2001, pra pas vdekjes së autorit. Ai nuk është libri më i rëndësishëm i Luhmann-it, as më i famshmi, as më kompleks. Ky libër përbëhet nga artikuj e intervista të botuara nëpër gazeta të përditshme gjermane ose referate të mbajtura nëpër konferenca, ku shtjellohen shkurtimisht pjesa më e madhe e temave të veprës voluminoze të tij.

Se si ishte Luhmann, i lindur në vitin 1927 në Lüneburg, si person privat, këtë lexuesi mund ta imagjinojë tek lexon intervistën (Biografi, pozicione, kartoteka) e parë, ku ai flet për kohën e nazizmit, fëmijërinë dhe rininë e tij që përfundoi në burgun ushtarak amerikan, për rrugën e tij nga student i së drejtës në punonjës administrate e më pas profesor sociologjie, dhe për metodën e punës së tij, kartotekën, që në disa qarqe akademike ka status kulti.

Me artikullin e dytë (Çfarë është komunikimi) lexuesi ka rastin të njihet pak më thellë me konceptin bazë të sociologjisë luhmanniane, komunikimin,

dhe risinë që solli ky koncept në krahasim me veprimin komunikues që ndjek rivali kryesor i tij në opinionin gjerman, Jürgen Habermas. Në tre artikujt e mëpasshëm (Mohuesit e përhershëm dhe banditët terroristë, Alternativë pa alternativë dhe Edhe brenda, edhe kundër) Luhmann fokusohet kryesisht te kultura e protestave që nisi të zinte një vend të rëndësishëm në Gjermaninë Federale të viteve gjashtëdhjetë.

Pas një intermexoje të shkurtër për lehtësinë dhe rëndesën e futbollit si simbol (Futbolli) vijojnë artikujt për vështirësitë e përshkrimit të së ardhmes (Risk në çdo rast) si dhe për taktikat e partive konkurruese në zgjedhje (Si votuam), për efektin që ka prezantimi tendencioz i shifrave në masmedia te atmosfera e përgjithshme në vend (Depresione statistikore), për raportin liri / detyrim në kontekstin zgjedhor (Kirurg në park) dhe për marrëdhëniet e sipërmarrjeve me opinionin publik (Art konceptual). Ky libërth i vogël mbyllet me një intervistë mbi dashurinë (Prandaj dashuri) të zhvilluar nga Dirk Baecker, një nga nxënësit kryesorë të tij, sot profesor në Universitetin privat gjerman Witten-Herdecke, dhe me një artikull me udhëzime sesi të lexohet një tekst i panjohur shkencor (Si të lexojmë).

Në këtë artikull të fundit Luhmann, ndër të tjera, shpjegon edhe vështirësinë që ka përkthyesi që

nuk e njeh kontekstin e shkrimit për të dalluar se cilat janë fjalët e rëndësishme dhe cilat janë ato më pak të rëndësishme dhe, për rrjedhojë, të zëvendësueshme. Luhmann vetë nuk i jep dot zgjidhje dilemës së përkthyesit dhe i këshillon studentët që të mësojnë sa më shumë gjuhë të huaja në mënyrë që tekstet t'i lexojnë në origjinal. Është afërmendsh që kjo vlen para së gjithash për tekstet aq komplekse të Luhmann-it. Kemi pasur fat, që përkthyesja Anila Shuka, e cila këmbënguli të merresha me redaktimin e këtij libri, e njeh mirë kontekstin e shkrimeve të tij, pasi është marrë intensivisht me të gjatë studimeve të ekonomisë dhe sociologjisë në Universitetin e Hamburgut. Në këtë drejtim besojmë se po ofrojmë një përkthim shumë të afërt me origjinalin. E megjithatë jemi të vetëdijshëm se ky përkthim nuk e zëvendëson kurrësi origjinalin, por së paku hap një dritare dhe i jep mundësi lexuesit të marrë disa grimca prej ideve komplekse luhmanniane që, siç shihet edhe në këtë libër, nuk e kanë humbur aspak aktualitetin.

Dr. Klementin Mile

Kush flet ose shkruan duhet të shprehet në mënyrë të kuptueshme. Në vështrim të parë, kjo është një kërkesë legjitime. Përse shprehesh, kur nuk dëshiron të të kuptojnë? Por sociologjia nuk është lëmi e vështrimit të parë, por lëmi e vështrimit të dytë. Vetëm me vështrimin e dytë vijnë pyetjet dhe mendimet. U dashka patjetër që gjithçka që thuhet të futet menjëherë në tutelën e kuptueshmërisë? A do të thotë kuptueshmëri: kuptueshmëri për këdo? Kuptueshmëri pa u sforcuar? Pa u parapërgatitur fare, pa shpenzuar aspak kohë me përsiatje e çkodime? A ka një vijueshmëri lineare nga pakuptueshmëria në kuptueshmëri dhe ku pritet të ketë më shumë kuptueshmëri? Mos vallë gjatë rrugës nga pakuptueshmëria drejt kuptueshmërisë, ka edhe ca devijime, siç është për shembull, keqkuptueshmëria. Apo mos ndoshta çështja e të pakuptueshmes mund të zgjidhet vetëm duke i rritur njëherazi të dyja, si kuptueshmërinë ashtu edhe keqkuptueshmërinë?

* * *

Mendoj se nganjëherë nuk na mungon proza erudite, por poezia erudite. Ka ca teori shkencore që kanë frymë apokaliptike të cilën nuk e formulojnë vetë ..., dhe ndoshta as nuk e vënë re. Orvatjet e pjesshme për interpretimet politike të mesazheve “të vërteta” të teorive dëshmojnë për ekzistencën e një nevoje të

paplotësuar për një variant të dytë. Ndoshta në këso rastesh do të ishte më mirë që arritjet e veçanta në teori të riformuloheshin në një si tip poezie, çka do ta kthente gjuhën e shkencës sërish te kufijtë e sistemit funksional të cilit ajo i përket.¹

1. Marrë nga: Soziologische Aufklärung 3, Opladen, Westdeutscher Verlag 1983, F. 170, 184v. (shën. i përkth.)

Biografi, atituda, skedarë¹

Intervistë

Zoti Luhmann, në Gjermaninë Federale ka dy përfaqësues të shkencave sociale, që gëzojnë një popullaritet të jashtëzakonshëm, Jürgen Habermas dhe ju. Për Habermas-in e kuptojmë. Qasja normative me të cilën ai trajton konceptin e tij për “subjektivitetin e pacenuar” i ka dhënë veprës së tij karakter politik: Grupimet që kanë në program ndryshimin e shoqërisë kanë parë mundësi të përballen me të në mënyrë produktive. E thënë shkurt, popullariteti i Habermas-it vjen si pasojë e përballjes së politikës me teorinë e tij. Gjë që për ju nuk mund të thuhet. Nga rezulton atëherë interesimi i madh për Luhmann?

Nuk është e lehtë të gjendet një shpjegim për këtë. Duhet dalluar dy faza të “receptimit të Luhmann”. E para ishte nga fundi i viteve ‘60. Në atë kohë ishin kryesisht lexues të majtë që interesoheshin për teorinë time, sepse baza e ideve të Shkollës së

1. Titulli i origjinalit: *Biographie, Attitüden, Zettelkasten*, në: *"Archimedes und wir"*, Berlin, Merve, 1987, f. 125-155

Frankfurtit është relativisht e thjeshtë, por realizimi i programit paraqet vështirësi. Ndërsa sot, më duket se problemi qëndron gjatë. Sot nuk mbizotëron aq shumë interesi për komplementaritetin e Teorisë Kritike, sesa interesi për teori me struktura solide. E megjithatë, edhe mua më ka befasuar ky interesim i madh për teorinë time, sidomos për librin tim të fundit “Soziale Systeme” [shqip: Sisteme Sociale].

Pra, zhgënjimi prej Teorisë Kritike zgjon interesim për teorinë e Luhmann?

Unë mendoj se me konceptin teorik të “Shkollës së Frankfurtit”, nëse ekziston një i tillë, nuk mund të punohet shkencërisht. Është një qëndrim që nuk është shumë i ndërlikuar, nuk është shumë i pasur në variante. Teoria Kritike nuk është aq komplekse sa të provokojë diçka tjetër, përveçse një sjellje protestuese ose dorëzuese. Rruga që përdor Habermas, duke diskutuar e sintetizuar teori të ndryshme, deri tani nuk e ka çuar atë në një pozicion sistematik të vetin.

Meqenëse ju kritikoni Teorinë Kritike, pasi kjo nisët nga një pozitë e caktuar, po teoria juaj, a është neutrale?

Unë do të thosha se në strukturat e saj teoria ime

është më e hapur kundrejt shumë sferave shoqërore, është më e hapur për të krahasuar anët pozitive dhe negative të shoqërisë moderne. Problemi i Habermas-it është se koncepti i tij është organizuar rreth një detyrimi moral të teorisë së shoqërisë. Nga njëra anë, kjo e bën këtë teori veçanërisht tërheqëse, por nga ana tjetër, tregon edhe kufijtë e saj. Nga një pozitë e tillë, disa aspekte si, fjala vjen, ekonomia monetare, jurisprudenca ose aparati politik, ose nuk mund të vëzhgohen fare, ose mund të vëzhgohen vetëm në mënyrë negative, kritike dhe refuzuese.

Zoti Luhmann, na lejon t'i kthehemi edhe një herë Jürgen Habermas-it, rivalit tuaj të madh në shkencë. Habermas ka thënë dikur se mendimi i tij shkencor ngrihet mbi një ide bazë. “Intuita rrjedh nga sfera e komunikimit me të tjerët, ajo ka si synim përvojën e një “intersubjektiviteti të pacenuar”. “Bashkëjetesa miqësore” (Brecht) është për Habermas-in ideja themelore që përcakton mendimin e tij. Zoti Luhmann, po ju çfarë ju shtyn të merreni me shkencë?

Nuk e di nëse mund ta përmbledh në një formulë. Nëse po, atëherë gjithsesi do të ishte një formulim shumë më ideor apo teorik. Për shembull, mua më duket më e frytshme që teoritë të mos nisen nga

uniteti, por nga diferenca, dhe të mos përfundojnë në unitet (në kuptimin e pajtimit), por në një, si ta them, diferencë më të mirë. Prandaj për mua është e rëndësishme, për shembull, sjellja e sistemeve ndaj ambientit, por edhe funksionalizmi, sepse ky bën të mundur të krahasohen edhe gjëra të ndryshme mes veti. Pra, nëse mund të flas për një intuitë bazë, atëherë nuk do të ishte patjetër kjo që sapo përshkrova, po diçka e ngjashme. Në raste të veçanta, kjo tek unë ndryshon në mënyrë periodike: herë është i rëndësishëm koncepti i funksionit, herë diferenca sistem-ambient, herë figura e vetëreferencës, herë diferenca ndërmjet operimit dhe vëzhgimit. Pas kësaj pozite shkencore, qëndron ideja se gjithçka mund të bëhet më mirë se çfarë ofron literatura e deritanishme. Prandaj duhet pritur njëherë para se të bëhen gjykime morale ose kritika, derisa të shihet sesi mund të mendohet për shoqërinë moderne.

Fantazitë për pajtim, si për shembull të njeriut me natyrën ose të njerëzve me njëri-tjetrin, janë për ju tërësisht të panjohura?

Natyrisht, nuk janë krejt të panjohura, por mendoj se ato nuk kanë luajtur ndonjë rol. Në mendimet e mia si shkencore dhe, meqë ra fjala, ashtu edhe ato politike, themelor është eksperimentimi.

Çka na befason te mendimi juaj është mospjesëmarrja juaj personale në ndërtimin e teorive. Ndërsa te marksizmi dhe te tradita e teorive pasardhëse të tij kanë qenë pikërisht përvojat politike personale që kanë motivuar punën shkencore. Zoti Luhmann, na shpjegoni, ju lutem, përse ju ka interesuar diferenca?

Paramendoni njëherë situatën e vitit 1945, se si e përjeton atë një 17-vjeçar: Më përpara çdo gjë i qe dukur në rregull, edhe më pas çdo gjë i dukej prapë në rregull, gjithçka kishte ndryshuar dhe gjithçka kishte mbetur njësoj. Më parë kishte pasur probleme me regjimin, por as më pas nuk ishte siç e kishte pritur. Ndoshta për këtë arsye edhe studimi i drejtësisë u bë shumë i rëndësishëm për mënyrën time të të menduarit.

Çfarë keni parasysh kur thoni se para vitit 1945 dhe pas vitit 1945 gjithçka ishte ndryshe, dhe njëkohësisht gjithçka ishte njësoj?

Para vitit 1945 shpresonim se pas rënies së aparatit shtetëror gjithçka do të rregullohej vetvetiu. Por, gjëja e parë që përjetova në burgun amerikan, ishte që më morën orën nga dora dhe më rrahën. Pra, nuk ishte aspak ashtu siç kisha kujtuar unë më parë. Edhe më pas u pa se krahasimi ndërmjet

regjimeve politike nuk mund të bëhej përgjatë aksit “mirë/keq”, por, se figurat duhen gjykuar brenda realitetit të tyre të kufizuar. Natyrisht, nuk dua të them me këtë se e konsideroj epokën e nazizmit të barasvlershme me periudhën pas vitit 1945. Por, pas vitit 1945 thjesht u zhgënjeva. Por a ka rëndësi kjo? Gjithsesi, përvoja ime me regjimin nazist nuk ishte morale, por më shumë një përvojë me arbitrarizmin, me pushtetin, me taktikat shmangëse të njerëzve të zakonshëm. Pra, siç e shihni, nuk synoj të dal te uniteti, me përjashtim të atyre rasteve, kur e njoh me saktësi diferencën, prej së cilës duhet krijuar ai unitet.

Krahas përvojës me periudhën para dhe pas vitit 1945, ju përmendët studimin e së drejtës, si faktor që ka ndikuar në mënyrë të veçantë te mendimi juaj. Përse ka qenë me rëndësi për mendimin tuaj studimi i jurisprudencës, që, në fakt, ka shumë pak të bëjë me sistematizimin teorik?

Jam i sigurt se e drejta mund të studiohet krejt ndryshe nga çë studiova unë. Unë studiova në radhë të parë të drejtën romake dhe, çfarë ishte e nevojshme për provimet, e vura në plan të dytë. Më interesonin përsiatjet që kishin si pikënisje një çështje dhe që çështjet t'i vendosja në një renditje të caktuar. Veç kësaj, më interesonin veçanërisht

pyetjet që kishin të bënin me të drejtën e krahasuar, e cila më parapërgatiti në një farë mënyre për sociologjinë, sepse, kur krahason të drejtat, duhet të jesh në gjendje të shpjegosh edhe rrethanat e ndryshme në aspektin sociologjik.

Pra, ju nuk e studiuat të drejtën me mendimin për t'u bërë, të themi, avokat?

Posi, në fillim doja të bëhesha avokat. Por, kur gjatë stazhit m'u desh ta fitoja bukën e gojës te një studio ligjore e një qyteti të vogël, kuptova se ajo punë nuk ishte për mua. Sidomos, nuk më pëlqeu që nuk kisha vetëm një epror, por shumë, të cilët vinin në zyrë me lloj-lloj kërkesash të parealizueshme e që nuk mund t'i refuzoja. Prandaj kalova në administratë, sepse kjo – përkundër përshtypjes që mund të krijohet në pamje të parë – dukej se më jepte më shumë liri. Aty shumë shpejt nisa të bëja punë me karakter më shumë politik.

Nga këndvështrimi i sotëm ky është një hap i çuditshëm. Një i jashtëm e ka të vështirë të dallojë ish-nëpunësin e administratës Luhmann, kur lexon librin “Soziale Systeme”. Përse nuk u bëtë shkencëtar fill pas studimeve dhe stazhit?

Në universitet nuk kishte asgjë që të më interesonte.

Nuk doja të bëhesha kurrsesi jurist universiteti. Kjo, për mua, nënkuptonte diçka të vogël, diçka që përsëritet vazhdimisht.

Por edhe si nëpunës administrate ju nuk kishit më shumë hapësirë të lirë, apo jo? Çfarë bënte Luhmann, si nëpunës administrate?

Në fillim isha një vit në Gjykatën e Lartë Administrative të Lüneburg-ut për të organizuar një sistem referimi për vendimet e Gjykatës Administrative: Synimi ishte që gjykata të shihte se çfarë vendimesh ishin marrë në Gjykatën e Lartë. Paralelisht isha asistent i presidentit dhe, veç kësaj, në fillim shëtisja nëpër senate të ndryshme për t'u njohur me të gjithë. Pas një viti përfundova në Hannover, ku sapo ishte ndërruar qeveria dhe kishin dalë probleme sidomos me çështjet e dëmshpërblimit nga nazizmi. Kështu që, në vitin 1955 hyra në Ministrinë e Kulturës së Saksonisë së Poshtme për të rishikuar mëkatet e së kaluarës nga pikëpamja juridike. Nëpër dosje gjen ende ndonjë koment ironik.

Si për shembull?

Për shembull, se përse i refuzonin dëshmitë e dëmshpërblimit, ose se përse nuk mund të merrej vesh që makina e punës ishte blerë për

djalin e ministrit. Pas tre muajsh më dhanë një departament, ku kisha si detyrë të kontrolloja të gjitha procedurat e dëmshpërblimeve. Megjithëse bëra kësisoj disa vjet në Ministrinë e Kulturës, nuk pata asnjëherë interes t'i hyja një karriere të mirëfilltë nëpunësi. Më kujtohet një bisedë me një referent nga Ministria e Brendshme, që më thoshte se nuk do të bëhesha kurrë nëpunës, nëse nuk do të punoja në ndonjë rreth. Përgjigja ime ishte: "Unë lexoj Hölderlin-in". Me kalimin e kohës kjo punë nisi të më rëndonte shumë. Në fillim mund ta lija punën në orën pesë dhe t'u kushtohesha interesave të mia të tjera. Por, me shtimin e detyrave, kjo shumë shpejt do të bëhej e pamundur.

Çfarë bënit ju në orën pesë, kur përfundonit punën?

Lexoja shumë dhe para së gjithash fillova të punoja me një kartotekë, pra, mbushja skeda. Nëpër skeda përpunoja literaturën, me të cilën merresha më së shumti, pra, sociologji dhe filozofi. Asokohe lexoja kryesisht Descartes-in dhe Husserl-in. Në teorinë sociologjike merresha me funksionalizmin e hershëm, me teoritë e Malinowski-t dhe Radcliffe-Brown-it; kjo bënte që të merresha intensivisht me antropologjinë kulturore dhe etnologjinë. Kurse antropologjinë filozofike gjermane nuk e kam pëlqyer kurrë. Më duhet të përmend edhe interesin

për Kant-in, ndërsa Hegel dhe Marx asokohe thujse nuk më interesonin fare.

Pas qëndrimit tuaj në Universitetin Harvard ju u larguat nga administrata e Hannover-it. Patët asokohe në Harvard ndonjë përjetim kyç që ju shtyu drejt këtij vendimi?

Jo, këtë nuk mund ta them. Kur shkova në Harvard kisha në plan të shkruaja një libër për teorinë e organizimit, i cili më vonë doli nën titullin “*Funktionen und Folgen formaler Organisation*” [Funksione dhe pasoja të organizimit formal]. Në Harvard mësova të punoja me arkitekturën e teorisë së Parsons-it, prej së cilës mësova shumë. Koncepti që kisha para se të shkoja në Harvard për nocionin e funksionit binte ndesh me atë të Parsons-it. Për këtë kemi diskutuar shumë asokohe, por përgjigja e tij ishte gjithmonë stereotip: “It fits quite nicely.” Kështu i integronte ai idetë e mia në teoritë e tij, ndërkohë që unë kisha përshtypjen se prej kësaj dilte diçka krejt tjetër. Ideja ime ishte se funksioni nuk ishte në varësi të strukturave, por se ai ishte vetëm një aspekt i zëvendësueshëm (ekuivalencë funksionale). Për mua ishin me interes mundësitë e shumta, të cilat ishin të ndryshme, por kishin të njëjtin funksion. Pra, siç e shihni, nuk mund t’ju rrëfej ndonjë përjetim të veçantë a sensacional. Ajo që më interesonte në plan të parë ishte sesi

është ndërtuar një teori si ajo e Parsons-it dhe se ku dështon ajo, nëse dështon. Asokohe bëheshim shumë me Parsons-in.

Me përgjigje të tilla nuk ia lehtësoni punën një biografi.

Biografia është një përmbledhje rastësish, vijimësia vjen nga ndjeshmëria ndaj rastësive. Prandaj edhe biografia ime mund të përshkruhet me një varg rastësish: kthesa politike në vitin 1945, të cilën e prita me shumë kureshti, studimi i jurisprudencës, ku përvetësova jo vetëm një mori marifetesh organizimi, por edhe një farë realizmi, i cili më bëri përfundimisht të paaftë për vetadministrimin universitar dhe, sigurisht, së fundmi, studimi i Parsons-it dhe Husserl-it, pra, bashkimi i analizës së kuptimit me nocionin e funksionit.

Përse jeni i paaftë për vetadministrimin universitar?

Mendoj se aty ka shumë situata, në të cilat ke të bësh vetëm me cikërrima që fitojnë kuptim vetëm duke i bërë të tjerët të shqetësohen për to. Vendimet nuk mund të delegohen. Një mbledhje komisioni ndjek tjetrën dhe askush nuk beson kur thua se të gjitha këto punë mund të kryheshin shumë më lehtë.

Kur kaluat më vonë në Shkollën e Lartë të Administratës (Verwaltungshochschule) në Speyer a ju lindi dëshira të bëheshit profesor?

Një punë administrative, qoftë edhe me pozitë të lartë, pas një farë kohe, kthehet në rutinë, kështu që nisa të kërkoja mundësi për të dalë nga kjo fushë. Unë doja të fitoja më shumë kohë për interesat e mia teorike, çka nuk do të thotë se doja të bëhesha profesor universiteti. Kisha dëshirë të bëhesha shkencëtar. Te ky përfytyrim nuk kishte aspak rëndësi mendimi që shkencën të kishte një vlerë praktike. Nuk mendoja se dijet e shkencës mund të zbatoheshin në praktikë. Praktika, për shembull, një ministri, është për mua një sistem që ecën sipas logjikës së vet, që përthith nga ambienti shkencor atë që është interesante për të. Ju e shihni se nuk synoj një teori të aplikueshme. Më shumë më tërheq ideja se teoria, sikurse praktika, bëhet më e ndërlikuar kur i jepet mundësia t'i përmirësojë pohimet e saj sipas standardeve të veta.

Por ju punoni për institucione praktike.

Kohët e fundit shumë pak. Dikur kisha më shumë mundësi se sot për t'u angazhuar në komisionet e Bonn-it. Kam këmbëngulur gjithmonë që një

komision t'i njihte paraprakisht synimet e politikës. Pra, para se të përpilohet diçka, të pyetj ministri ose zyrtari kryesor: A doni këtë apo atë kurs? Por kjo mënyrë të menduari me alternativa, bie ndesh me të gjitha praktikat, kështu që nisa ta refuzoja bashkëpunimin nëpër komisione të tilla.

Kjo që thoni ju, zoti Luhmann, e nxjerr si jo shumë të bazuar kritikën që bëhet shpesh ndaj jush se teoria juaj i shërben justifikimit të gjendjes ekzistuese. Si e shikoni ju këtë?

Sigurisht, kjo kritikë është e padrejtë dhe e painformuar. Për shembull, kam qenë njëherë në një komision për reformimin e statusit të nëpunësve, në të cilin nuk u arrit të pranohej as pozita konservatore e as ajo progresive. Kam shpenzuar shumë kohë për të bashkëpunuar për përpilimin e një strukture të re për administratën publike, e cila u pranua nga komisioni, por jo nga qeveria. Ju e shihni se veprimtaria ime politike ka qenë krejt e padobishme, thjesht u përpoqa t'i shmangesha gjendjes së paktit politik të komisionit, që ishte i programuar paraprakisht për shkak të përbërjes së tij. Në këtë kontekst pashë sesa pak mundësi ka politika për të parë alternativat strukture dhe për të përlogaritur pasojat e qëndrimeve politike tek ato. Sigurisht, kjo

e përforcoi gjykimin tim se sistemi politik ndjek një logjikë të vetën. Më vonë pata të bëja edhe një herë me partinë Bashkimi Kristiandemokrat (CDU), kur diskutonte programin bazë, por kjo ishte një aksiologji e mirëfilltë, të cilën nuk arrita ta ktheja te diagnoza e realitetit. Por një program duhet ta përshkruajë shoqërinë ashtu siç është, e jo vetëm të numërojë vlerat që gjithkush i konsideron të mira. Sigurisht, CDU-ja e kuptoi se propozimet e mia nuk mund të ecnin si platformë zgjedhore, sepse Partia Socialdemokrate (SPD) kishte të njëjtat vlera. Pra, kontaktet e mia me politikën nuk kanë qenë shumë të frytshme.

Pra, prej jush nuk mund të përfitojë një parti politike?

Jo. Në vitet '90 kam pasur më shumë kontakte me SPD-në, sidomos me Arbeitsgemeinschaft Sozialdemokratischer Juristen [Grupi i punës i juristëve socialdemokratë], më vonë më shumë me CDU-në. Parimisht mendoj se gjithnjë duhet të jesh i hapur ndaj politikës dhe i gatshëm për bashkëpunim. Vetëm se: kufizimet që vë politika janë shumë të mëdha për shkencëtarët dhe në praktikë shpesh pamundësia fillon aty ku shkencëtari nuk shikon asnjë vështirësi serioze.

Zoti Luhmann, ne nuk e shohim diferencën ndërmjet programit dhe analizës, sepse çdo program ka si bazë analizën e një gjendjeje të caktuar të shoqërisë. A mendoni ju se e shihni botën në mënyrë objektive?

Unë mendoj se në politikë duhen shtruar çështje që kanë të bëjnë me realitetin. Pra, sigurisht, një politikan mund të pyetet para zgjedhjeve, për shembull, nëse i përshkruan strukturat ekonomike si kejniane apo si monetariste, këto janë pyetje që kanë të bëjnë me realitetin. Por, unë nuk dua të di nëse një politikan është për barazi dhe liri. Do të më interesonte të dija edhe nëse ka diçka që ai e konsideron të perealizueshme.

Një gjë nuk e kuptojmë: si person privat ju ndiqni çdo ditë një sërë orientimesh normative, si për shembull kur është fjala për edukimin e fëmijëve tuaj. Ndërsa, kur e shikoni veten si individ në kuadrin e një shoqërie, atëherë ju nuk doni të drejtoheni nga orientimet normative, nga vlerat. Si mund të shpjegohet kjo kontradiktë? Nuk e njihni ju konceptin e detyrimit që ka shkencëtari ndaj një pozicionimi moral?

Po dhe jo. Sigurisht, unë nuk nisem nga përfytyrimet e mia private për të shpjeguar çështjet publike,

por, nga ana tjetër, kam edhe disa ndjeshmëri që përcaktojnë orientimet e mia politike. Për shembull, irritohem kur politikanët nuk e zbatojnë ligjin, kur, për shembull, për shkaqe të caktuara politike, i lënë të lirë uzurpuesit e shtëpive. Nuk jam aspak kundër që të ndryshohen ligjet dhe të legalizohet uzurpimi i shtëpive, por nuk më duket e drejtë që ligji të mos zbatohet për arsye politike. Ky qëndrim politik është i lidhur me interesin tim personal për të ditur se a mund t'i realizoj të drejtat e mia, apo jo. Më lejoni të tregoj një shembull tjetër. Unë dëgjova njëherë nga një bisedë me disa planifikues fushatash zgjedhore, se fjalimet nuk duhen bërë shumë të komplikuar, sepse njerëzit duan vetëm të dinë se kush janë të mirët dhe kush të këqijtë. Ta shohësh kështu partinë rivale më duket shumë problematike, sepse opozita gjithmonë duhet të jetë e pranueshme moralisht. Edhe në politikën e Bonit personalisht më irriton moralizmi në përshkrimin e kundërshtarit politik. Në aspektin teorik, më shqetëson që nuk kemi më alternativa zgjedhore. Në Amerikë, për shembull, ky kufi respektohet gjithmonë qartë: McCarthy-t i erdhi fundi kur e shkeli këtë kufi në vitet '50. Ju e shihni se tek unë ka qëndrime që mund të personalizohen qartazi, sigurisht, por ato zënë vetëm një hapësirë relativisht të vogël. Por mendoj se unë mund ta bëj dallimin ndërmjet mendimeve

që më orientojnë mua, të themi, si zgjedhës politik dhe problemeve të konstruktive teorike, që më interesojnë si shkencëtar.

Po ju me siguri që e keni një përfytyrim sesi do të duhej të ishte më së miri shoqëria?

Jo. Kam shumë pyetje, për shembull, njëra është se a është mirë të ketë gërshetime kaq të ngushta ndërmjet bankave dhe sipërmarrjeve prodhuese. Sistemi amerikan, për shembull, më duket më i mirë. Por nuk kam asnjë përfytyrim sesi mund të jetë një shoqëri e mirë, ose më e mirë. Mendoj se shoqëria jonë ka më shumë veti pozitive dhe më shumë veti negative se çdo shoqëri e mëparshme. Pra, sot është edhe më mirë, edhe më keq. Kjo mund të përshkruhet shumë më saktë, por nuk mund të përmbliidhet në një gjykim të përgjithshëm.

Që nuk keni utopi shoqërore, e kuptojmë, edhe pse me shumë vështirësi. Por me siguri që do të keni dëshira dhe ëndrra personale që ju vijnë ndër mend kur rrini ulur në ballkonin tuaj të bukur dhe nuk keni mendime të tjera.

Absolutisht jo. Për shembull, mua më pëlqen dielli. Më pëlqen të punoj në diell. Parapëlqej një lloj të caktuar muzike dhe arti, por, nëse ka diçka

që dëshiroj për veten, është që të kem më shumë kohë. E vetmja gjë që më shqetëson është mungesa e kohës. Mund ta përfytyroja fare mirë që për mua dita të kishte 30 orë, ndërsa për dikë tjetër vetëm 24. Të tjerët duhet të jenë në gjumë, kur unë vazhdoj të merrem me çfarë të mundem.

Pra, Luhmann nuk ka utopi, as si person privat e as si individ politik?

E kam të vështirë të kem dëshira. Sigurisht, njeriu do që të ketë aq para sa të mos e vrasë mendjen për çdo dhemb të ri ose për çdo gomë të re makine. Por përtej kësaj...

Nuk mund ta përfytyroni të bëni diçka krejt tjetër, për shembull, të merreni me art?

Do të kisha shumë dëshirë të studioja edhe disa gjëra të tjera, si për shembull, matematikë dhe ekonomi.

Pra, jo diçka krejt tjetër.

Jo.

Njëherë në jetën tuaj filluat të merreshit me diçka krejt tjetër. Nga nëpunës administrate u bëtë profesor.

Po, kjo është e vërtetë. Por, për momentin, pyetje të tilla nuk janë aktuale për mua. Por përfytyroj se do ta kisha të vështirë, nëse dikush do të më ofronte një funksion politik. Por nuk merrem fare me mendime të tilla.

A mund t'i kthehemi edhe një herë punës suaj në Shkollën e Lartë të Administratës në Speyer dhe fillimit si profesor i sociologjisë? Zoti Luhmann, ju e keni mbrojtur doktoratën në moshën 39-vjeçare dhe në të njëjtën kohë bëtë punimin e habilitimit dhe pastaj u bëtë menjëherë profesor sociologjie në Universitetin e Bielefeld-it. A nuk është kjo një karrierë e pazakontë shkencore?

Me që ra fjala, m'u desh të studioja edhe sociologjinë, sepse deri atëherë kisha mësuar vetëm jurisprudencën. Vështirësia praktike ishte se nuk kisha qenë asnjëherë asistent, por këshilltar i lartë i qeverisë dhe kur donin të më bënë profesor, dolën shumë probleme teknike. Unë personalisht e pranova këtë transformim profesional. Një katedër sociologjie më interesonte shumë, sidomos sepse si sociolog mund të bësh gjithçka, pa u fiksuar në një sferë të caktuar tematike. Kisha shpresë se në Bielefeld do të krijohesh një universitet ku do të kishte shumë punë kërkimore.

Ju përmbush kjo shpresë?

Jo, për fat të keq, jo. U bë një universitet krejt i zakonshëm.

E megjithatë, ju në këtë universitet arritët të shkruanit 150 artikuj dhe 30 libra. Si arrihet kjo brenda një periudhe 15-vjeçare?

Jo, pas pak do të mbushen 20 vjet. Nëpër artikuj e libra unë nuk synoj përsosmërinë, si disa që janë të mendimit se duhet të shkruajnë një vepër finale qysh me librin e parë. Sa kam shkruar deri tani ka qenë pjesë e një “serie testuese” në kuadër të prodhimit të një teorie, – me përjashtim të, ndoshta, librit më të fundit *Soziale Systeme*.

Është ky botimi juaj i parë i mirëfilltë?

Është sidoqoftë pikënisja për publikimet e trashëgimisë, nëse mund t'i quajmë kështu. Këtë libër nuk do ta hedh poshtë aq shpejt, edhe pse qysh tani, shumë gjëra do t'i bëja ndryshe. Për t'iu përgjigjur pyetjes suaj për sasinë e publikimeve, këtë do ta shpjegoja edhe me teknikën e kartotekës sime. Unë nuk i mendoj vetë të gjitha, një pjesë të madhe e bën kartoteka.

Librat tuaj shkruhen vetë, kështu keni thënë ju diku në librin tuaj më të fundit. A mund të na e zbuloni këtë të fshehtë?

Kohën më të madhe e shpenzoj duke shtypur dorëshkrimin. Pasi e kam shkruar, zakonisht nuk e rishikoj më, me përjashtim të librit më të fundit, tek i cili kam punuar shumë edhe me stilin. Prodhimtaria ime mund të shpjegohet në thelb me sistemin e kartotekës. Meqë ra fjala, këtu kanë ardhur shumë njerëz për ta parë. Me kartotekën kam filluar të punoj qysh gjatë studimeve, në fillim të viteve pesëdhjetë. Nëse më lejoni t'jua shpjegoj shkurtimisht: të gjitha skedat kanë nga një numër fiks, radhitja nuk është sistematike, pra, kartoteka nuk është e renditur në mënyrë sistematike. Pas numrave vjen nga një nënndarje e mëtejshme, për shembull, a, b, c, a1, a2, a3 etj., që nganjëherë arrin deri në 12 shifra. Prej secilit numër mund të kaloj në çdo skedë tjetër të kartotekës. Pra, nuk ka linearitet, por një sistem në trajtën e rrjetit të merimangës, i cili mund të fillojë ngado. Kësisoj, vendimi se çfarë duhet të fus në kartotekë e ku duhet ta vë atë mund të jetë i çfarëdoshëm, me kusht që mundësitë e tjera të jenë të ndërlidhura me referenca. Kur e bën këtë vazhdimisht, nis e krijohet një strukturë e brendshme, e cila nuk ka qenë e paramenduar si e tillë, por që mund të përftohet më pas. Kartoteka

më merr më shumë kohë se shkrimi i librave.

Çfarë përmban një skedë e tillë?

Kryesisht mendime personale, nganjëherë edhe citate, por kjo ndodh shumë rrallë. Në kartotekë ka edhe referenca burimore, por për literaturën kam dy sisteme më vete, prej të cilave gjithashtu mund të kalohet te kartoteka.

Nëse e kemi kuptuar saktë, ju nuk humbni asnjë mendim: gjithçka që ju ka kaluar nëpër kokë, hyn menjëherë në kartotekë?

Po, por jo çdo gjë që kam mbledhur në kartotekë përdoret më vonë.

Kur filloni të shkruani një artikull, si e vini në përdorim kartotekën tuaj?

Në fillim bëj një plan se për çfarë dua të shkruaj dhe prej kartotekës nxjerr atë që mund të më hyjë në punë.

Në dallim nga një ndërtues, që vetëm sa monton parafabrikate, një shkencëtar duhet të ketë edhe ide të reja që nuk gjenden nëpër këto pjesë. Ide të tilla sikur nuk vijnë nga një kartotekë, apo jo?

Posi. Unë për shembull kam një sasi të madhe me skeda për nocionin “diferencim funksional”, kam gjithashtu një mori shënimesh për “sistemet vetëreferenciale” dhe kam një kompleks të madh me shënime për “binaritetin”. Për momentin po punoj për një referat për problemet ekologjike në shoqëritë moderne dhe detyra ime është që t’i sistemoj dhe t’i kombinoj skedat nga këto tri fusha konceptuale që të mund të them diçka substanciale për këtë temë. Idetë e reja dalin pastaj nga mundësitë e ndryshme të kombinimeve të skedave për secilin nocion. Pa skedat, pra, vetëm me mendime, nuk do të dilja te këto ide. Sigurisht, nevojitet mendja ime për t’i shënuar idetë, por ajo nuk mund të quhet përgjegjëse e vetme për to. Në këtë pikë punoj si një kompjuter që, duke kombinuar të dhënat e marra, nxjerr rezultate të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin të parashikueshme. Kjo teknikë, kështu mendoj unë, shpjegon edhe se përse unë nuk mendoj aspak në mënyrë lineare dhe se kur shkruaj libra kam vështirësi që të gjej renditjen e duhur të kapitujve, sepse faktikisht çdo kapitull do të duhej të rigjendej në çdo kapitull tjetër. Librin tim më të fundit *Soziale Systeme* prandaj e kam rirenditur shumë herë dhe shumë vonë vendosa ta trajtoja teorinë e sistemeve në mënyrë abstrakte në një kapitull më vete në fillim.

Sa kohë ju është dashur të punonit për librin tuaj të fundit?

Pjesën më të madhe e kam shkruar dhe konceptuar brenda një viti. Por, natyrisht, pati përpunime, kryesisht stilistike.

Sa orë në ditë shkruani ju?

Kjo varet. Kur nuk kam ndonjë gjë tjetër për të bërë, shkruaj tërë ditën: që nga ora 08:30 në mëngjes e deri në drekë, pastaj bëj një shëtitje të shkurtër me qenin, pastaj kam kohë edhe njëherë nga ora 14:00 deri më 16:00, pastaj prapë i vjen radha qenit. Nganjëherë shtrihem për një çerekore, jam mësuar që të pushoj shumë i përqendruar, në mënyrë që pas një kohe të shkurtër të mund të punoj sërish. Dhe pastaj, zakonisht, shkruaj edhe në mbrëmje deri në orën 23:00. Në orën 23:00 zakonisht jam në shtrat dhe lexoj edhe ca gjëra që ende mund t'i përtyp në atë orë. – Duhet t'ju them se nuk e detyroj veten asnjëherë për asgjë, gjithmonë bëj vetëm atë që më duket më e lehtë për t'u bërë. Shkruaj vetëm kur e di menjëherë se çfarë duhet të bëj. Kur ngec për një moment, e lë atë gjë dhe merrem me diçka tjetër.

Dhe çfarë bëni?

Epo, shkruaj libra të tjerë. Unë gjithnjë punoj paralelisht me disa libra. Me këtë metodë, duke punuar gjithnjë në disa gjëra njëherësh, nuk kam asnjëherë bllokime.

Pra, nuk rrini asnjëherë një ditë pa shkruar?

Kur jam në shtëpi, jo.

Pra, puna nuk është për ju një mundim, në fund të të cilit është një shpërblim me mospunë?

Jo, këtë nuk e njoh fare. Shpesh ndodh që të më vërshojnë mendimet dhe do të doja të punoja në disa gjëra njëherësh.

Keni pasur ndonjëherë ndjenjën se po sakrifikoni për punën tuaj, ose ndjenjën se po humbni diçka?

Jo, përkundrazi. Shpesh kam përshtypjen se ndonjë problematikë nuk e kam kuptuar aq saktë sa duhet. Kur shkruaj, nuk kam ndjenjën se po më ikën diçka tjetër, vetëm kur jam në udhëtim jashtë më ndodh shpesh që pas një farë kohe të mendoj se tani duhet të kthehem për të vazhduar shkrimin.

Ju nuk i përmendni fare marrëdhëniet me

njerëzit e tjerë, me gruan, fëmijët. Cila është arsyeja?

Gruaja më ka vdekur, shoku më i mirë më ka vdekur: fëmijët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të jetës sime. Me ta dhe me kulturën rinore rreth tyre bashkëjetoj unë këtu. Kurse bashkëmoshatarët e mi, me të cilët do të kisha dëshirë të rrija, i kam humbur, është e vështirë të zëvendësohen.

Ju qysh atëherë jetoni me tre fëmijët tuaj këtu në Oerlinghausen?

Po, fëmijët qysh në fillim kanë qenë shumë të pavarur për shkak të kushteve në të cilat u rritën. Pas vdekjes së sime shoqeje, shkoja jashtë shtetit për maksimumi dy ose tri ditë dhe kthehesha menjëherë për t'u kujdesur për ta. Sot kemi një ndihmëse në shtëpi, ajo vjen katër herë në javë dhe gatuan.

A mund t'i kthehemi edhe njëherë historisë suaj? Në çfarë familje jeni rritur, pra, cilat kanë qenë rrethanat emocionale që ju mundësuan të zhvillonit një inteligjencë kaq të jashtëzakonshme?

Si në familjen e babait, ashtu edhe në atë të nënës, bijtë e parë nuk studionin, lejoheshin të studionin

vetëm ata që nuk mund të qëndronin në shtëpi. Im atë, i cili nuk kishte studiuar kurrë, e pat marrë fabrikën e birrës dhe majasë nga i ati në një moment kur ajo nuk sillte më rendiment. Ne mund të jetonim nga ato të ardhura, por gjithmonë kishte njëfarë problematike financiare. Im atë pati pastaj probleme me nacional-socializmin, kështu që në familje ndihej njëfarë distance, por jo gjithnjë e dukshme. Nëna ime ishte zvicerane dhe nuk kishte lidhje me shkencën. Por familja ime ishte tolerante, pasi mund ta vendosja vetë se çfarë doja. Ata nuk kishin ndonjë përfytyrim për përzgjedhjen e profesionit. Për nga tradita familjare studimi nuk ishte diçka e vetëkuptueshme; ata që nuk mund të merrnin trashëgimi, duhet të studionin. Mamaja ime vinte nga një familje hotelierësh, për të cilët ishte e vetëkuptueshme që të ndërtonin hotele edhe për bijtë e dytë ose të tretë. As dy vëllezërit e mi nuk studiuan.

Pra, ju nuk morët asnjë shtysë të drejtpërdrejtë për punën tuaj të mëpasshme si sociolog dhe filozof. Si e shpjegoni që këto fusha u bënë pasion në jetëshkrimin tuaj?

Nuk e di. Ndoshta kishte të bënte me lirinë që kisha në familje; ato gjëra që i bëje mirë, ata i konsideronin të mira.

Në shkollë me siguri që ishit më i miri i klasës.

Jo. E kapërceva një klasë, sepse gjyshja ime kishte lexuar në gazetë se kjo ishte e mundshme. Kështu u bëra ndihmës i Forcave Ajrore qysh në moshën 15-vjeçare, ndërsa të tjerët bëheshin në moshën 16-vjeçare. Por nuk kam ndonjë gjë tjetër shumë interesante për të treguar. Me që ra fjala, nuk besoj te determinizmi prej ndodhive jetësore. Biografitë janë më shumë një varg rastësish që organizohen në diçka që dalëngadalë bëhet më pak e lëvizshme.

Duke u nisur nga këto pak të dhëna biografike që na skicuat, a shihni ju një lidhje me mënyrën tuaj të punës, me punën me kartotekën?

Jo. E fillova kartotekën duke u nisur nga ideja e thjeshtë se kam kujtesë të dobët. Në fillim pusullat me shënime i vendosja nëpër libra, por kjo mënyrë prishte kapakët e librave. Pastaj nisa të përdorja dosje, por kur këto u bënë të trasha, nuk gjeja më asgjë në to. Prej vitit 1952 ose 1953 fillova me kartotekën, sepse m'u bë e qartë se duhej të planifikoja për një jetë e jo vetëm për një libër.

Në moshën 25-vjeçare ju bë e qartë se duhej të bënit plane për një jetë?

Po. Doja të mblihdja dije dhe të krijoja mundësi kombinimi. Në një farë mënyre kartoteka është një reduktim për organizimin e një kompleksiteti. Kur lexoj një libër, për shembull, veproj kështu: gjithmonë mbaj në dorë një letër, ku shënoj idetë e disa faqeve të caktuara. Në anën e pasme shënoj të dhënat bibliografike. Pasi përfundoj leximin e librit, i rishikoj këto shënime dhe mendoj se çfarë mund të më hyjë në punë e për cilat skeda. Pra, lexoj gjithnjë duke pasur parasysh skedueshmërinë e librave. Ndoshta kam thjesht një prirje për koleksion. Nëse me kartotekën time formuloj teori, nuk jam i mendimit se kjo është parapërgatitja për një perceptim të drejtë të realitetit, por shumë-shumë për një perceptim, prej të cilit pastaj varen vendimet e mëpasshme, të cilat, edhe në qofshin të gabuara, janë të paktën të gabuara saktë. Kështu teoria ndërton mosarbitrarizmin e brendshëm të saj. Udhëzimet që përdoren sot në shkencë e që parapërcaktojnë sesi duhet menduar, nuk i pranoj dot lehtë.

Pra, teoria juaj, zoti Luhmann, është më tepër e orientuar nga testimi i alternativave të ndryshme sesa nga arsyetimi i pikëpamjeve të formuluar më parë. Megjithatë, ne nuk e kuptojmë sesi ju mund të punoni pa orientime

normative, kur parashtroni propozime për reforma politike, çka e bëni herë pas here. A është për ju qëndrueshmëria e një strukture organizative kriteri i vlerave, tek i cili orientoni propozimet tuaja?

Më lejoni t'ju përgjigjem me një shembull nga reforma e statusit të nëpunësit. Si pikënisje për këtë propozim kanë qenë ca mangësi në strukturën ekzistuese të aparatit të nëpunësve. Gjatë punës sime në ministri munda të vëzhgoja se politika e dhënies së gradave administrative nuk bëhej për të punësuar më së miri njerëzit në fazën e tyre produktive, ndërmjet moshës 40 dhe 55-vjeçare, por ata gradoheshin për të përmirësuar gjendjen e pensionit. Kështu për shembull, kishte nëpunës që në moshën 63-vjeçare bëheshin Këshilltarë Zyrtarë për të dalë më pas në pension e për ta liruar këtë post për nëpunësin tjetër të radhës. Një politikë e tillë nuk orientohet nga punësimi optimal i kualifikimeve të njerëzve, por karakterizohet nga mendësia e përkujdesjes: Të gjithë duhet të kenë ndjenjën se një ditë do të bëhen Këshilltarë Zyrtarë. Një shembull tjetër: Te ne nuk është e përfytyrueshme që nëpunësit – nëse e lejojnë rrethanat – të degradohen në mënyrë që, kur të përmirësohen kushtet, të gradohen sërish në pozicionet e tyre të mëparshme. Në vend që të

bëhet kjo, kur nuk ka më punë për ta, ata mbesin në të njëjtën gradë dhe dërgohen në një si gati-pension. Në Amerikë është krejt ndryshe. Ulja dhe ngritja e gradave atje është diçka normale dhe nuk dënohet moralisht. Një propozim i këtillë, siç është normalizimi i ngritje-uljeve, dështoi për shkak të ngurtësisë së aparatit të nëpunësve. Qasja ime nuk synon medoemos të nxjerrë si të drejtë njërin apo tjetrin model, mua më intereson të shqyrtoj alternativa të ndryshme për nga kushtet dhe pasojat e tyre. Kjo formë mendimi e përshkon të gjithë programin tim shkencor. Pikënisja e mendimit tim është kjo: në qoftë se zgjedhim ta shohim botën në një mënyrë të caktuar, atëherë cilat janë rrjedhojat e kësaj zgjedhjeje?

Si mund të diskutoni për alternativa, kur nuk keni një ide në mendje se çfarë gjeni të mirë apo të drejtë?

Kësaj unë nuk mund t'i përgjigjem me saktësi për çdo çështje. Për shembull, kur vras mendjen për politikën ndaj nëpunësve, kam ide krejt të tjera nga ato që do të kisha po të mendoja një koncept për politikën bankare. Përgjithësisht mund të them se defektet e prodhuara nga struktura më duken të shmangshme në realitet – me kusht që të pranohen disa mangësi të tjera, të cilat janë të padukshme,

sepse për to nuk ka ende alternativa. Kjo mënyrë mendimi nuk më duket aspak konservatore.

Kjo është e kuptueshme. Por nga vjen kritika se teoria juaj është konservatore?

Përshtypja ime është se pozicioni progresiv është zënë me figura të caktuara teorike; çfarë nuk përputhet me këto figura teorike, është e kundërta e progresives, pra, konservatore. Ky stereotip vjen nga mendimi që kanë për veten ata që mua më quajnë konservator. Ndërsa përshtypja ime është se në Shkollën e Frankfurtit ende luan rol një konservatorizëm moral apo një konfiguracion i Europës së Vjetër. Por, ç' është e vërteta, kjo figurë nuk më duket aq e rëndësishme. Nëse me të vërtetë je konservator, atëherë sot të duhet të ndryshosh jashtëzakonisht shumë gjëra, që të mund të shpëtosh diçka prej gjithë këtyre transformimeve. Në këto rrethana, ç' kuptim ka të flitet për "konservatorizëm"?

Nëse përfytyroni njëherë hapësirën kohore të dhjetëvjeçarit të ardhshëm, cilat probleme politiko-shoqërore do të quanit më urgjente?

Edhe këtu kam vështirësi të shkëpus një pikë të veçantë. Mendoj se në diskutimin e deritanishëm

disa pika janë lënë më në hije, prandaj dhe unë gjithmonë prirem të përmend pika të tjera, të ndryshme prej atyre për të cilat flasin të gjithë në këtë moment. Pra, në qoftë se unë nuk e përmend që në krye politikën e paqes, atëherë kjo nuk do të thotë se jam për luftë apo se nuk më duket e rëndësishme ruajtja e paqes. Nuk ka nevojë të flitet fare për pasojat e tmerrshme që do të kishte një makroluftë, kjo është më se e qartë.

Angazhoheni ju në lëvizjen pacifiste?

Jo. Ajo për mua është shumë pranë luftës, tepër luftarake, nëse më lejohet ta them kështu. Lëvizja pacifiste mbështetet mbi premisa që nuk i shoh si paqenxitëse. Për shembull, nuk e konsideroj si paqenxitëse politikën e çarmatimit. Mendoj se duhen harmonizuar strukturat e mendimit midis Lindjes dhe Perëndimit, jo në kuptimin e një *teorie konvergjence*, por në kuptimin që bota e ideve marksiste, e cila është konsumuar, të shpërbëhet, sikurse edhe bota e ideve liberale, e cila gjithashtu është konsumuar. Ne sot ende jetojmë me debatet e shekullit XIX, prandaj edhe shumë prej atyre që Lindja dhe Perëndimi kritikojnë te njëra-tjetra në aspektin teorik nuk kanë kuptim. Natyrisht, do të ishte e gabuar të mendohej se teoria është faktor me rëndësi politike. Megjithatë, kritikant

ndaj vetëkuptueshmërisë së amerikanëve dhe sovjetikëve, më duken se kanë kuptim dhe këto vërejtje për mua janë po aq pranë paqes, sikurse dhe politika e çarmatimit. Një opsion tjetër mund ta përfytyroja vetëm nëse do të arrihej të shmangeshin sulmet me raketa, çka sot nuk më duket e pamundur teknikisht. Por njerëzit do të fillonin t'i vërsuleshin njëri-tjetrit me thikat e frutave. Mua më shqetëson edhe fakti që askush nuk është i ndjeshëm ndaj mundësisë së evoluimit të epidemive që vijnë nga zhvillimi i mjekësisë. Ne kurrsesi nuk mund ta përjashtojmë mundësinë që një ditë të lindin viruse rezistente që thjesht do t'ia nisnin vrapit, ndërsa mjekësia nuk do të dijë ç'të bëjë dhe do t'i nevojiten vite për të gjetur diagnozën e sëmundjes. Një rast i tillë është probabël në teorinë e evolucionit për shkak të përdorimit të antibiotikëve. Një gjë e tillë më duket shumë më probabël se një shpërthim gjigant që asgjëson njerëzimin. Ose merrni një shembull tjetër, siç është zhvillimi i dollarit. Dollari është bërë monedhë kryesore, vetëm sepse është zhytur aq shumë në borxhe sa që nuk lejohet as të ulet, e as të zëvendësohet. Nuk ka aspak siguri që dollari një ditë nuk do të pësojë kolaps. Probabilitetin e një kolapsi të një sistemi ekonomik të fryrë monetarisht, e për të cilin nuk ka kompensim, e shoh si një problem jashtëzakonisht urgjent, përballë të cilit çjerrjet

kundër kapitalizmit më duken pavend. Për këto çështje problemi nuk qëndron te pronari i mjeteve të prodhimit. Një teori e përpunuar duhej të tregonte më shumë risqe dhe rreziqe sesa një teori e ngushtuar e marksizmit të vonë ose se aversioni i rëndomtë ndaj teknologjisë.

A do të jetë pjesë e punës suaj të ardhme, që të analizohen defekte të tilla strukturore të shoqërive të kapitalizmit të vonë?

Puna ime e mëtejshme do të merret me një teori shoqërie, e cila është në një nivel më të ulët abstraksioni se libri *Soziale Systeme*. Por aty nuk do të bëj “kritikën e shoqërisë” në kuptimin e rëndomtë, as nuk do të përpiloj vetëm një listë me efektet ndaj strukturës e le më të përdor konceptin e gabuar, “kapitalizëm i vonë”. Probleme të tilla shfaqen vetëm brenda teorisë. Meqenëse nuk synoj ndonjë shoqëri të ndryshme nga kjo që kemi, dua të paraqes anët e shumta pozitive të sistemit tonë. Pra, nuk është fjala për refuzim a miratim të kësaj shoqërie, por për një kuptim më të mirë të risqeve strukturore të saj, vetërrezikimeve të saj, mosprobabilitetit të saj evolucionar.

Pra, nuk do të ketë shkrime të vogla politike nga Niklas Luhmann?

Jo. Por kjo nuk do të thotë se nuk do të trajtoj edhe probleme aktuale në kontekstin e një problemi teorik.

*Intervistën e zhvilluan
Rainer Erd dhe Andrea Maihofer, 1987*